


POEZIA



SHQIPE

SPIRO
COMORA



P. Sh. - 1
C 78

59254

BIBLIOTEKA E SHËTIT
CHROKASTER


11920

POEZIA

SHQIPE

SPIRO
ÇOMORA

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI



Spiro Çomora

KOZMOS

I

Dhe Shkencëtari i tha Poetit:
«Kozmos, i dashur mik! vdiq poezia!
Ish shumë e vogël bota
që ju kënduat...
Patë në verë lart në qiell
një diell,
e thurët përralla
për gjinkalla
e milingona...
Shikuat hënë, motrën tonë,
duke lëshuar
dritë t'ergjëndë përmbi ne,
edhe u frymëzuat
vetëm për puthje dashurie...
s'patë veç kaltërsin' e hapësirës,
pultijen e yjeve
dhe format e çuditshme të reve,

e s'patë Kozmosin,
Mendimin...
Ish shum' e vogël bota
që ju kënduat...
Po sot
me krahë madhështorë rend Mendimi
larg Tokës, tutje,
ndër miriada Botë fantastike
që nuk do quhen më
«Kashta e kumtrit»...
Kozmos, i dashur mik! Vdiq Poezia!
Do të harrohen shpejt
lundrimet n'oqeane
e ndër akuj polesh,
para lundrimeve kozmike
që do të prishin
heshtjen e ftohtë të planeteve!
Ish shum' e vogël bota
që ju kënduat...
Kozmos, i dashur mik! Vdiq Poezia!»

II

«S'vdes! — iu përgjegj Poeti
Shkencëtarit —

Njerëzimi
po flinte akoma

në terrin e Mendimit
kur ndjeu
atë gëzim të parrëfyer
të dallëndyshes
që merr të fluturojë
rrotull folesë për së pari...
Ç'ëndërr e bukur!
Ujërat e kaltra të Egjeut
i kish qëndisur Dielli
me miriada gurë të shkëlqyer
atë mëngjez
kur Mjeshtri plak me djalin
i rrahën krahët
dhe nisën fluturimin...
I biri, pranë,
me zjarrin e rinis'
në gji,
i dehur fort nga kjo magji,
u ngjit, u ngjit
lart e më lart përherë...
Po Dielli,
sikur çdo mbret
kur i cënohet mbretëria,
u skuq nga zemërimi;
e, thonë, se ja treti krahët...
I biri u mbyt,
por ëndrra e Mjeshtrit plak
jetoj në shekuj...

Sot,
Mendimi u nis
për sulmin drejt Përjetësisë!
S'vdes Poezia!
Titanë,
që shkulni me rrëmbim
shkëmbinj sa Dheu
e i lëshoni lart drejt hapësirës
duke shkallmuar mbretërinë e Zotit,
ju vetë shkruani
një Poezi,
që do t'jua kish zili
dhe Këngëtari plak
i Trojës!»

PATRIOTËT

Ish ato dit' kur Peza kishte ftuar
shqiptarët më të mirë në kuvend
që t'i bashkonte, jo për të luftuar
me kukurece, po me gjithë mend:
me pushkë që bën bam e bukë thatë,
e jo duke përtypur çokollatë...

E kur atje buçiste e bubullinte
dhe flaka merrte dheun, në Tiranë
paria kombëtare hingëllinte
«për Shqipëri!» në grazhdet veteranë,
ku hante e s'ngopej, shtruar këmbëkryq,
tagjin' që i kishin vënë disa miq!

Ish ato dit' që i pashë ata të tre
duke pirë raki për mëmëdhe...

Çdo mbrëmje shkonin n'atë pijetore.
Ishin: një tregëtar fort i praruar,
një funksionar me një bastun në dorë
— shënjë se rroga ecte e pandryshuar —
edhe i treti në seri një tjetër
që e hiqte veten patriot i vjetër...

Ata miq kishin qenë kurdoherë,
po tani von' i bashkoi fort bardhaku
që kthenin në një qoshe dimër-verë,
sepse i brente fort ai meraku:
si do t'i bëhej halli Shqipërisë
që ra në duart e fëmijërisë...

Të tretin e thërrisnin «patrioti»,
jo vetëm se nga mosha ish i shkuar,
po se ish një nga ata që kur baroti
për mëmëdhe buçiste në krahuar,
ai, me sa tregonte, dhe kur flinte
vetëm atdhenë e dashur endërrinte...

Prandaj i bënin nder edhe e çmonin
këtë ushtar të vjetër t'idealit,
pasi, në fund të fundit, po mendonin
se çunave, që kishin dalë malit,

vetëm ky patriot me ca të tjerë
mund t'ua hante kokën menjëherë.

Dhe patrioti nuk përtonte fare
së foluri për ngjarjet kombëtare...

U fliste për Naimin — po pa shtuar
se e urrente që s'ish turçeli...
Fliste me zjarr për shqipen e bekuar —
sado që fliste turçe në shtëpi...
Dhe pasi çlodhej ndonjë grimë
n'ato kujtime, me një psherëtimë,
u thoshte për Çerçizin ndonjë fjalë,
për Mashkullorën edhe për Njëzetën —
po për vete nuk thoshte asnjë fjalë
si e ku kish luftuar për kuletën;
as për një shenjë plage mbi lëkurë
që kish në mes të ballit, s'fliste kurrë...

Po pikërisht kjo plagë mu në ballë
— që kish formën e plagës kombëtare —
të tjerve ua bënte mendjen dhallë...
Prandaj ata të dy s'dyshonin fare
se ajo shenjë atje ish dokument
i një patriotizmi permanent...